



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 182

18 nëntor

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 166/2013 datë 24.10.2013	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 6, datë 4.10.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”” 7711
Dekret nr. 8388 datë 12.11.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 7711
Vendim i KM nr. 985, datë 8.11.2013	Për lirin dhe emërimin në detyrë të drejtorit të përgjithshëm të Institutit të Integritetit të të Përndjekurve 7712
Vendim i KM nr. 988, datë 8.11.2013	Për miratimin e planit të veprimit për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar 7712
Vendim i KM nr. 999, datë 25.10.2013	Për kriteret dhe procedurat e përfaqësimit, të përzgjedhjes, të emërimit e të shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave..... 7718
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Adriatik Vinçani 7720

LIGJ
Nr. 166/2013

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 6, DATË 4.10.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN
NR. 119/2012 “PËR BUXHETIN E VITIT 2013””**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 6, datë 4.10.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013””.

Miratur në datën 24.10.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8387, datë 12.11.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

DEKRET
Nr. 8388, datë 12.11.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--|--|
| 1. Nadir Nuho Sulejmanoviq | 9. Natalja (Natalia) Vasilij Gollovashçenko (Golovashchenko) |
| 2. Nexhat Ismet Rama | 10. Besim Bahri Mahmuti |
| 3. Mimoza Sadedin Gjata (Bunjaku) | 11. Nizamettin Mehmet Gökdemir |
| 4. Alban Halil Bilalli | 12. Skender Halil Sadrija |
| 5. Metin Onur Osman Kara | 13. Arben Vesel Robaj |
| 6. Mustafa Abdullah Ataş | 14. Shkurta Ali Nesimi (Simnica) |
| 7. Huda Munther R.F. Abu Shaaban (Abushaban) | 15. Marselha Cristina Teomar de Moura Kacani (de Moura) |
| 8. Etrit Sadudin Berisha | 16. Irina (Iryna) Oleksandr Romanova |



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 985, datë 8.11.2013

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË
INSTITUTIT TË INTEGRIMIT TË TË PËRNDJEKURVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr. 8246, datë 1.10.1997 “Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Simon Miraka, drejtor i përgjithshëm i Institutit të Integrimit të të Përndjekurve, lirohet nga kjo detyrë.
2. Z. Bedri Blloshmi emërohet drejtor i përgjithshëm i Institutit të Integrimit të të Përndjekurve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 988, datë 8.11.2013

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Integrimit Evropian, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ministria e Integrimit Evropian bashkërendon e monitoron zbatimin e planit të veprimit dhe raporton çdo javë në Këshillin e Ministrave për ecurinë e procesit.
3. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore i raportojnë Ministrisë së Integrimit Evropian, çdo javë, për realizimin e detyrimeve që rrjedhin nga plani i veprimit.
4. Ngarkohen të gjitha ministrinë dhe institucionet qendrore, për të cilat në planin e veprimit janë përcaktuar detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLAN VEPRIMI

Çështjet	Objektivat	Hapat që do ndërmerren në zbatim të objektivave	Institucioni përgjegjës	Afati/periudha e realizimit
Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK)	Të përgatitet mandati i qartë dhe strategjia / plani i veprimit për Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit.	Përcaktimi i fushave të përgjegjësiave të KKK	Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore (MSHCV)	Nëntor 2013
Strategjia kundër Korrupsionit 2014-2017	Të nisë hartimi i Strategjisë së re kombëtare kundër Korrupsionit, me tregues të qartë për rezultatet, si edhe me mekanizmin e ndjekjes dhe monitorimit	Hartimi i planit të punës së KKK për periudhën vazhdim Fillimi i procesit të hartimit të Strategjisë Antikorrupsion (2014-2017)	MSHCV MSHCV	Nëntor 2013 Nëntor 2013
Organizimi i Konferencës së lartë kundër Korrupsionit	Të nisë hartimi i Strategjisë së re kombëtare kundër Korrupsionit, me tregues të qartë për rezultatet, si edhe me mekanizmin e ndjekjes dhe monitorimit	Hartimi i draftit të parë të strategjisë Takim me donatorët për Anti-korrupsionin Aplikimet pranë TAIEX	MSHCV MSHCV MSHCV	Nëntor 2013 - Prill 2014 Tetor 2013* Tetor 2013*
Organizimi i Konferencës së lartë kundër Korrupsionit	Koordinatori kundër Korrupsionit të garantojë përgatitjet e duhura, duke vënë në dispozicion materiale konkrete dhe duke koordinuar ministrinë e linjës si dhe përfundimet operacionale, në bashkëpunim me Komisionin.	Puna parapërgatitore për anën organizative të konferencës Organizimi i konferencës Folloë up – përfundimeve dhe përfshirja e rekomandimeve në Strategjinë Antikorrupsion	MSHCV MSHCV MSHCV	Tetor 2013* 12 – 13 Nëntor 2013 Nëntor-Dhjetor 2013
Vlerësim i kuadrit të përgjithshëm antikorrupsion	Të mbahet Konferenca kundër Korrupsionit. Të përfshihen rezultatet dhe përfundimet operacionale në Strategjinë kundër Korrupsionit 2014-2017 (që do të hartohet). Të shqyrtohen vlerësimet e deritanishme të kuadrit anti-korrupsion, përfshi vlerësimet e riskut dhe rekomandimet e PACA-s, në funksion të zbatimit të rezultateve dhe vlerësimit të mëtejshëm. Të aplikohet pranë TAIEX-it për vizita studimore, me qëllim që të fitohet përvojë praktike mbi shkëmbimin e informacionit dhe mekanizmat koordinues ndërmjet organeve ligjzbatuese.	Analizat e Vlerësimit të Riskut të përgatitura nga PACA Aplikimet për mbështetje nga TAIEX Organizimi i një projekti 6 mujor për vlerësimin e strukturës anti-korrupsion	MSHCV MSHCV MSHCV Ministria e Integritetit Evropian (MIE)	Tetor-Nëntor 2013 Tetor 2013* Dhjetor 2013 Nëntor-Dhjetor 2013



Eficenca e hetimeve	Të aplikohet pranë TAIEX-it për vizita studimore në Shtete Anëtare të ndryshme për të mësuar mbi modelët e kuadreve të përgjithshme anti-korrupsion.			
	Të përgatitet një projekt 6-mujor për të vlerësuar kuadrin anti-korrupsion dhe për të ndihmuar në zbatimin e përfundimeve të Konferencës së nivelit të lartë kundër Korrupsionit (një projekt i IPA 2013 pritet të japë mbështetje të mëtejshme).	Rivlerësimi dhe rishikimi i MOU ekzistues	MSHCV & Ministria e Drejtësisë (MD); Ministria e Punëve të Brendshme (MPB);	Dhjetor 2013
	Të nënshkruhet një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet të gjitha institucioneve të përfshira – organet ligjzbatuese dhe Ministrinë (në vend të Memorandumeve dypalëshe) për bashkëpunimin në luftën kundër krimeve të rënda (korrupsioni dhe krimi i organizuar)	Hartimi i MOU të reja ndërmjet organeve ligjzbatuese	MPB	Dhjetor 2013
	Të merren masat e para konkrete për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet organeve ligjzbatuese, duke realizuar mes të tjerash nisma, operacione dhe hetime të përbashkëta.	Hartimi i marrëveshje së bashkëpunimit MPB-PP-Shërbimi Informativ	MPB; Prokuroria e Përgjithshme (PP); Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH)	Tetor - Nëntor 2013
	Të punohet për të arritur një vijimësi rezultatesh (track record) në lidhje me hetimet financiare, duke u fokusuar në rastet e pasurive të pasqjegueshme.	Nënshkrimi i marrëveshjes operacionale me EUROPOL	MPB	Nëntor 2013
		Përditësimi i statistikave të harmonizuara dhe Track Records Fokus të veçantë hetimi i aseteve të pasurive të pajustificuara;	MPB; MD; Ministria e Financave (MF); PP	Nëntor 2013
	Të shqyrtohet Kodi i Procedurës Penale, ligji për Policinë e Shtetit dhe ligji për Komunikimet Elektronike, me qëllim që hetimet të kryhen pa probleme (përfshi përmes përgjimit) dhe të dhënat të merren pa vonesa nga autoritetet kombëtare dhe operatorët telefonikë.	Rishikimi i KPP	MD	Shtator 2014
		Rishikimi i ligjit për policinë e shtetit	MPB	Dhjetor 2013
		Rishikimi i ligjit për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm		
		Marrja e masave konkrete për reformën në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm.		
		Analizim i ligjit për komunikimet elektronike në lidhje me pëmbushjen e kërkesës për lehtësimin e hetimeve, duke përfshirë ditënen e propozimeve për ndryshime ligjore nëse janë të nevojshme	Ministër Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike (MSHIAP); MPB; MD;	Dhjetor 2013

	Të merren masat e para për të lehtësuar aksesin / lidhjen me databazat dhe regjistrat përkatës për kryerjen e hetimeve.	Inventari i data bazave ekzistuese Rishikimi i kuadrit ligjor për sigurimin e aksesit në data bazë institucionale	MSHCV, MD MPB, MD	Dhjetor 2013 Nëntor 2013
Vijimësia e rezultateve (TR)	Të përmirësohen statistikatat për vijimësinë e rezultateve (track record) dhe të futen elementët e vlerësimit, analizës dhe interpretimit të riskut (projekti i UNODC për statistikatat në fushën DÇB mund të ndihmojë)	Sigurimi i aksesit – në të gjitha bazat e të dhënave funksionale	MPB, MD	Dhjetor 2013
	Të aplikohet pranë TAIEX-it për vizita studimore që të mësohet më shumë mbi raportimin statistikor për rastet e korrupsionit dhe krimin të organizuar.	Rivlerësimi i formatit të statistikave të harmonizuara, për të bërë ato sa më të lexueshme, të përputhshme dhe të sakta	MD, MPB, PP	Dhjetor 2013
	Të enërohet dhe të trajnohet stafi në çdo organ ligjzbatues i ngarkuar me mbledhjen e të dhënave, si dhe me ruajtjen, monitorimin dhe analizimin e informacionit.	Aplikimet pranë TAIEX Caktimi i personave përgjegjës për harmonizimin dhe ndjekjen e statistikave me urdhër të përbashkët	MD, MPB, PP MD, MPB, PP	Nëntor 2013 Nëntor 2013
Organizimi i Policisë dhe Prokurorisë	Të shqyrtohet eficaenca e strukturave ekzistuese të ngarkuara me luftën kundër krimin të organizuar si edhe të propozohen përmirësime specifike. Ndërhyrjet mund të fokusohen në forcimin e qasjes institucionale duke marrë këto masa: (a) vlerësimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Krijimi i një grupi të specializuar Prokurorësh për fushat e krimin që kërkojnë aftësi teknike, si p.sh. krimi kibernetik; (b) vlerësimin i shtrijës së funksionimit të Njësisë e Përbashkëta Hetimore (NjPH) edhe në rrethe të tjera dhe të kompetencave hetimore të këtyre njësisë;	Rivlerësimi i eficaencës së strukturave ekzistuese në luftën kundër krimin të organizuar Rishikimi i kurrikulave të trajnimit – në bashkëpunim me shkollën e Magjistraturës- për rritjen e aftësive teknike të prokurorëve, me një fokus të veçantë tek veprat e reja penale të miratuara me ndryshimet e fundit të Kodit Penal, krimin kibernetik etj. Analize mbi kapacitetet e burimeve njerëzore në Prokurorinë për Krime të Rënda në raport me volumin dhe ngarkesën e punës Analize dhe vlerësimin i shtrijës së funksionimit të Njësisë e Përbashkëta Hetimore (NjPH) edhe në rrethe të tjera Ngritja e Byrosë së Hetimit Rishikimi i KPP (neni 75/a i tij dhe imunitetet, si dhe ligji antimatrafia neni 288, 289 i K.P.P, për te zgjeruar fushën e veprimtimit të ligjit)	MPB, PP PP; Shkolla e Magjistraturës (SHM) PP PP MPB MD MPB	Nëntor 2013 Nëntor 2013 Dhjetor 2013 Dhjetor 2013 Mars 2014 Nëntor 2013 Nëntor 2013
		Rivlerësimi i funksionimit të databazeve ekzistuese	MPB	Nëntor 2013



	(MEMEX), për përmirësime të mundshme			
Konfiskimi dhe administrimi i pasurive të krimit	Të përgatitet terreni për forcimin e transparencës dhe përmirësime të mëtejshme në lidhje me konfiskimin dhe administrimin e pasurive të krimit (përfshi vizita studimore të TAIEX-it dhe/ose seminare si edhe përfshirja e shoqërisë civile).	Aplikime pranë TAIEX Rishikimi i funksioneve të AAPSK Hartimi një plani masash për zbatim për muajt në vazhdim	MF MF MF	Nëntor 2013 Nëntor 2013 Dhjetor 2013
Roli i shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit	Të vendosen mekanizma vlerësimi të ankesave ndaj korrupsionit (linja telefonike falas, adresat e-mail), përfshi bazën e tyre ligjore dhe ndjekjen e rasteve të veçanta/vlerësimin e masave që janë marrë në lidhje me informacionin e siguruar.	Ngjytra/riaktivizimi i linjave të komunikimit me publikun në të gjitha institucionet shtetërore, duke përfshirë dhe rishikimin e bazës ligjore Ndërmarrja e një fushate publitare – për denoncimin e rasteve të korrupsionit Të sigurohet një Trak Rekord nga të gjitha institucionet për rastet e denoncuar nga publiku dhe të ndjekura nga organet ligjzbatuese	MSHCV MSHCV MSHCV	Dhjetor 2013 9 Dhjetor 2013 Dhjetor 2013
Trafikimi i Qënieve Njerëzore	Të rishikohet Vlerësimi i Kërcënimeve të Krimit të Organizuar në mënyrë që lufta kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore të vihet ndër prioritetet kryesore.	Rishikimi i vlerësimit të rrezikut për krimin e organizuar duke përfshirë Trafikimin e Qënieve Njerëzore ndër prioritetet kryesore Rivlerësimi i dokumenteve ekzistues në raport me prioritetin qeverisë	MPB MPB	Nëntor 2013 Nëntor 2013
	Rifunksionimi i Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Viktimat/Viktimat e Mundshme të Trafikimit (MKR) dhe rifunksionimi i Komitetit Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore; Rivendosja dhe fuqizimi i partneriteteve, veçanërisht partneriteti me shoqërinë civile; Forcimi i masave parandaluese dhe rritja e fushave ndërgjegjëse.		MPB	Dhjetor 2013

Operacionet kundër Trafiqeve	Të garantohen dhe të forcohen vlerësimi i rrezikut dhe kapacitetet operacionale në kufirin blu (Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), nisur nga skadimi i moratoriumit të sfafeve.	Hapat konkrete mbas skadimit të moratoriumit për sfafe, si ne forcimin e luftës kundër trafikeve, bashkëmenaxhimin e integruar të kufijve Forcimi i QNOD-se. Sigurimi i mbarrëvajtjes dhe mirëmbajtjes për projektet ekzistuese.	MPB, Ministria e Mbrojtjes (MM) etc.	Në vazhdimësi
Reforma në Gjyqësor	T'i kërkohej Komisionit të Venecias të vlerësojë organizimin e gjyqësorit dhe të japë rekomandime në funksion të forcimit të pavarësisë dhe llogaridhënies.	Ecuria e vlerësimit të gjyqtarëve - Vlerësimi i gjyqtarëve (për periudhën 2005-2006) - Vlerësimi i gjyqtarëve (mbledhje e dokumentacionit për vlerësimin e gjyqtarëve për periudhën 2007-2009) Ndryshimet në ligjin për KLD dhe MD (<i>Inspektoratet</i>)	Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) MD; KLD	Dhjetor 2013 Nëntor-Dhjetor 2013 Shtator 2014
Lehtësim i Procedurave Gjyqësore	Të miratohen ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, të finalizohet reforma për imunitetin, të kufizohen kompetencat e Gjykatës së Lartë (për çështjet penale) dhe të vendosen penaltete ndaj avokatëve që mungojnë në seanca gjyqësore.	Kërkesë në Komisionin e Venecias për të vlerësuar Sistemin Gjyqësor, për të hartuar rekomandime në kuadër të forcimit të pavarësisë dhe llogaridhënies Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale (dhjetor 2013) për të arritur: - Te limitohen kompetencat e Gjykatës së Lartë (për çështje penale) - Të përfshihet mundësia për të marrë masa ndaj Avokatëve të cilët mungojnë gjatë seancave gjyqësore	MD MD MD	Tetor – Nëntor 2013* Shtator 2014

ⁱ Masat e shënuara me shenjën (*) janë tashmë të realizuara



VENDIM
Nr. 999, datë 25.10.2013

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRFAQËSIMIT, TË PËRZGJEDHJES, TË EMËRIMIT E TË SHKARKIMIT, RREGULLAT E FUNKSIONIMIT DHE MASËN E SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 10 të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikën zyrtare”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përfaqësimit, të përzgjedhjes, të emërimit e të shkarkimit, të rregullave të funksionimit e të masës së shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave, me qëllim funksionimin korrekt të këtij këshilli, sipas legjislacionit në fuqi për statistikën zyrtare për garantimin e profesionalizmit, pavarësisë dhe integritetit të lartë moral, nëpërmjet kryerjes së procedurave transparente përzgjedhëse, duke u mbështetur në kriterë profesionale për të përmbushur detyrat e përcaktuara në ligjin e statistikave zyrtare.

2. Përzgjedhja e kandidatave për anëtarë të Këshillit të Statistikave kryhet nëpërmjet zbatimit të procedurave të hapura të konkurrimit, nën përgjegjësinë e sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimeve në pikat 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 e 12 të këtij vendimi.

3. Anëtarët e Këshillit të Statistikave janë përfaqësues të:

- a) Bankës së Shqipërisë 1 (një) anëtar;
- b) Ministrisë së Financave 1 (një) anëtar;
- c) përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare 2 (dy) anëtarë;
- ç) botës akademike 1 (një) anëtar;
- d) shoqërisë civile 1 (një) anëtar;
- dh) Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë 1 (një) anëtar.

4. Anëtarët e Këshillit të Statistikave, gjatë ushtrimit të detyrës, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave dhe informacionin që sigurohet prej tyre dhe të mos i përdorin ato për interesa personale.

5. Subjektet e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, jo më vonë se 1 (një) muaj para mbarimit të mandatit, duhet të dërgojnë me shkrim pranë sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, propozimin për 3 (tri) kandidatura për pozicionin e anëtarit në Këshillin e Statistikave.

6. Kandidaturat e paraqitura nga Banka e Shqipërisë, duhet të përmbushin këto kriterë:

- a) Të jenë nëpunës të nivelit drejtues, departamenti ose njësie;
- b) Të gëzojnë reputacion të lartë profesional;
- c) Të kenë njohuri për metodat statistikore;
- ç) Të kenë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë pune.

7. Kandidaturat e paraqitura nga ministri i Financave duhet të përmbushin këto kriterë:

- a) Të jenë nëpunës civilë të nivelit të lartë ose të mesëm drejtues;
- b) Të kenë njohuri në prodhimin apo përdorimin e statistikave;
- c) Të kenë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë pune.

8. Anëtari, përfaqësues i përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare, mund të jetë nga radhët e nëpunësve civilë të Kryeministrisë dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Kriteret, që duhet të përmbushin këto kandidatura, janë si më poshtë vijon:

- a) Të jenë nëpunës civilë të nivelit të lartë ose të mesëm drejtues;
- b) Puna që ata kryejnë të ketë lidhje me të dhënat statistikore;
- c) Të kenë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë pune.

9. Në rastin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve, përfaqësues nga bota akademike dhe shoqëria civile, sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave shpall dhe boton për 3 (tri) ditë radhazi, në dy gazetata me qarkullimin më të madh kombëtar dhe në faqen zyrtare të Kryeministrit, thirrje të hapur për kandidimin si anëtarë, përfaqësues të këtij grupimi.

10. Anëtari, përfaqësues i botës akademike, mund të jetë nga radhët e trupit akademik të institucioneve të arsimit të lartë, publik ose privat, i licencuar dhe i akredituar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë. Për të qenë përfaqësues të këtij grupimi mund të kandidojnë përfaqësuesit e botës akademike, të cilët përmbushin kriteret e mëposhtme:

- a) Të jenë pedagogë me kohë të plotë;
- b) Të kenë përvojë në punë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e statistikave ose ekonomisë ose shkencave të natyrës apo në fushën e përpunimit të statistikave gjinore;
- c) Të zotërojnë tituj shkencorë.

11. Anëtari, përfaqësues i shoqërisë civile, të jetë nga radhët e organizatave jofitimprurëse me reputacion, përvojë profesionale dhe njerëzore, i cili gjatë misionit të organizatës përdor ose bën studime në shkencën e statistikës, si dhe ka njohje të mira për gjendjen shoqërore e demografike të vendit, përfshirë edhe treguesit e varfërisë. Mund të kandidojnë për të qenë përfaqësues të këtij grupimi personat, të cilët plotësojnë këto kriteret:

- a) Të jenë të punësuar me kohë të plotë në organizata të shoqërisë civile, që kanë përvojë në fushën e statistikave ose ekonomisë, ose shkencave të natyrës apo shkencave sociale;
- b) Të kenë përvojë pune në njërin prej këtyre fushave jo më pak se 3 (tre) vjet;
- c) Të kenë përvojë në përdorimin e të dhënave statistikore.

12. Anëtari, përfaqësues i Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, të jetë nga radhët e anëtarëve të tij dhe me përvojë të spikatur në fushën ekonomike, si dhe të ketë përvojë të mëparshme në fushën e statistikës.

13. Sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, në rastet e krijimit të vendeve vakante për anëtarë në Këshillin e Statistikave, nis procedurat e njoftimit të subjekteve përkatëse, të përcaktuara sipas pikës 3 të këtij vendimi.

Sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave ngre një komision *ad-hoc*, i cili përbëhet nga dy përfaqësues të Kryeministrit dhe një përfaqësues i Universitetit të Tiranës. Ky komision nis procedurat e përzgjedhjes për kandidaturat e dërguara nga secili grupim, sipas pikës 3 të këtij vendimi.

14. Anëtari i Këshillit të Statistikave lirohet nga detyra nga Këshilli i Ministrave, kur:

- a) mbaron mandati;
- b) jep dorëheqjen;
- c) arrin moshën e pensionit;
- ç) mbaron ose përfundon marrëdhënien e punës me institucionin që ai përfaqëson;
- d) titullari i institucionit propozues i kërkon Këshillit të Ministrave zëvendësimin e tij për shkaqe të arsyeshme.

15. Anëtarët e Këshillit të Statistikave shkarkohen nga Këshilli i Ministrave sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikën zyrtare”, të ndryshuar.

16. Këshilli i Statistikave mbledhet, të paktën, 3 (tri) herë në një vit kalendarik. Mbledhja thirret nga kryetari i Këshillit të Statistikave. Në mungesë të tij, me miratim dhe porosi të kryetarit, mbledhja thirret nga anëtari më i vjetër në detyrë dhe, në mungesë të tij, nga anëtari më i vjetër në moshë.

17. Kryetari vendos për datën, kohën e mbledhjeve të radhës dhe njofton anëtarët e këshillit, të paktën, 5 (pesë) ditë para mbledhjes. Rendi i ditës u njoftohet anëtarëve jo më vonë se 2 (dy) ditë



para organizimit të mbledhjes. Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtar i Këshillit të Statistikave jo më vonë se 2 (dy) ditë para mbledhjes.

18. Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhjen kur atë e kërkon me shkrim, të paktën, 1/3 e anëtarëve të Këshillit të Statistikave ose drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it. Në këto raste, mbledhja organizohet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas kërkesës së paraqitur prej tyre.

19. Mbledhja është e vlefshme kur në të janë të pranishëm, të paktën, pesë anëtarë të këshillit. Mbledhja mbahet në përputhje me rendin e ditës. Diskutimet dhe vendimet për çdo pikë të rendit të ditës mbahen në procesverbal nga sekretariati i Këshillit të Statistikave.

20. Vendimet e Këshillit të Statistikave janë të vlefshme kur miratohen nga, të paktën, 5 (pesë) anëtarë të këtij këshilli dhe zbardhen brenda 3 (tri) ditëve nga data e mbledhjes.

21. Sekretariati i Këshillit të Statistikave sigurohet nga INSTAT-i. Sekretariati lehtëson organizimin e mbledhjeve, mban dokumentacionin përkatës të mbledhjeve, mban procesverbalin dhe e nënshkruan atë, pasi ua ka kaluar të gjithë anëtarëve për të konfirmuar saktësinë e tij dhe zbardh të gjitha vendimet e Këshillit të Statistikave.

22. Masa e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave për çdo mbledhje është sipas përcaktimit të bërë në vendimin nr. 418, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.

23. Ngarkohet sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, që, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, të nisë procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Statistikave në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi.

24. Kryeministria, Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Banka e Shqipërisë dhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dërgojnë të dhënat për kandidaturat, përfaqësues të tyre në Këshillin e Statistikave, të shoqëruara me një relacion shpjegues dhe dokumentacionin shoqëruar për plotësimin e kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.

25. Ngarkohet sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave për kryerjen e procedurave sipas pikës 9 të këtij vendimi, pas hyrjes në fuqi të tij.

26. Vendimi nr. 704, datë 16.11.2005 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kriterëve të përfaqësimit, të përzgjedhjes, emërimit e shkarkimit të anëtarëve dhe rregullat e funksionimit të Këshillit të Statistikave”, i ndryshuar, shfuqizohet.

27. Këshilli i Statistikave thërret mbledhjen e parë, brenda 1 (një) muaji nga konstituimi i mandateve të anëtarëve të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin e datës 8.11.2013, vendosi shpalljen e zhdukjes së shtetasit Adriatik Vinçani dhe caktimin si kujdestar të pasurisë, motrën e tij, shtetasen Zhulieta Balkalli.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 16 lekë